

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA MBI QASJEN NË BINAR NDËRMJET INFRAKOS-it DHE TRAINKOS-it

**Kryeshefi Ekzekutiv Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës Sh.A “INFRAKOS”
Mr.sc. Hysen Nikqi dhe Kryeshefi Ekzekutiv z. Gelor Shala nënshkruan marrëveshjen për
qasje në infrastrukturën e hekurudhave të Kosovës për vitin 2020 - 2021**

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.A “INFRAKOS” ka filluar të zbatoi programin e saj për vitin 2021 që ka si mision të vet ofrimin e shërbimeve për qasje në infrastrukturën e hekurudhave të Kosovës për të gjithë operatorët e transportit hekurudhor.



Me datë 23.03.2021 të dy kryeshefat ekzekutiv, ai i Infracos Sh.A z. Hysen Nikqi dhe kryeshefi ekzekutiv i Operimit me Trenat Trainkos Sh.A kanë nënshkruar marrëveshjen e qasjes në binar me qëllim të zbatimit të ekspozitës të rrjetit.

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës mbetet e përkushtuar të ofroi shërbime profesionale dhe siguri për të gjithë operatorët transportues hekurudhor.



Kryeshefi Ekzekutiv i Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës z. Hysen Nikqi i shprehi një falënderim të veçantë z. Gelor Shala për bashkëpunimin duke i dëshiruar që viti 2021 të jetë vit i bashkëpunimit për të dyja palët në zbatim të marrëveshjes si dhe në respektim të të gjitha akteve normative të zbatueshme në veprimtarinë hekurudhore.